

NUMRI I DOSJES: KSC-BC-2020-07

TITULLI I DOSJES: *Prokurori k. Hysni GUCATIT*

PARASHTRIM GJYKATËSIT TË VETËM: Gjykatës Nikola Giju

ADMINISTRATORE: Dr Fidelma Donlon

PJESËMARRËSI PARASHTRUES: HYSNI GUCATI

DATA E PARASHTRIMIT: 28 shtator 2020

GJUHA: anglishte

KLASIFIKIMI: Konfidencial

TITULLI I PARASHTRIMIT: Kërkesë për regjistrimin e paraqitjes së parë

PJESËMARRËSIT TË CILËVE DUHET T'U SHPËRNDARHET PARASHTRIMI:

Gjykatësit të Vetëm, ZPS-së

KËRKESË PËR REGJISTRIMIN E PARAQITJES SË PARASHTRUESIT TË
KËRKESËS PARA GJYKATËSIT NË PAJTIM ME NENIN 41(5) TË LIGJIT PËR
DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRËN E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR

1. Mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës (z. Hysni GUCATI), kërkon që paraqitja e parashtruesit të kërkesës para gjykatësit në pajtim me nenin 41(5) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, Ligji 05/L-053, të mbahet të enjten, 1 tetor 2020.
2. Mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës ka angazhime të mëhershme të martën, 29 shtator 2020, dhe të mërkurën, 30 shtator 2020.
3. Parashtruesi i kërkesës ka konfirmuar miratimin për kërkesën që paraqitja e parë e tij të mbahet të enjten, 1 tetor 2020.
4. Parashtrimi është protokolluar si konfidencial në pajtim me rregullën 82(1)(b) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara, meqenëse parashtruesi i kërkesës nuk përballet me aktakuzë të konfirmuar dhe nuk ka statusin e të akuzuarit. Në mungesë të aktakuzës së konfirmuar, vlen prezumimi i konfidencialitetit (shih rregullën 85(3), 85(4) dhe 86(2)).

/nënshkrimi/

XHONATAN ELISTAN RIS (JONATHAN ELYSTAN REES) QC
Mbrojtësi për parashtruesin e kërkesës